

ARSIMI NË SHQIPËRI NË PERIUdhËN 1925-1939

TEMA PËR TITULLIN  
MASTER I HISTORISË  
NGA  
RRUSTEM MEHMETI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
FAKULTETI FILOZOFIK  
DEPARTAMENTI I HISTORISË  
PRISHTINË

QERSHOR, 2023

## REZYME E TEMËS SË DIPLOMËS PËR NIVELIN MASTER

**Mentori:** Prof. Asoc. Dr. Muhamet Qerimi

**Kandidati:** Rrustem Mehmeti

**Tema:** Arsimi në Shqipëri në periudhën 1925-1939

Qëllimi i këtij studimi është trajtimi i temës: "Arsimi në Shqipëri në periudhën 1925-1939", dhe synimi është që të trajtohen ngjarjet kryesore të cilat kishin ndodhur në këtë periudhë për arsimin e shoqërisë shqiptare.

Në fillim të këtij punimi është bërë grumbullimi i literaturës adekuate dhe janë bërë hulumtime të tjera lidhur me literaturën relevante për temën bosht të çështjes së shtruar për studim. Ndërsa më pas ka ndodhur strukturimi i temës, e që në këtë aspekt, tema është e ndarë në 3 kapituj dhe në disa nënkapituj të cilave u paraprijnë: abstrakti, parathënia (ku shpjegohen qëllimet, metodat, pyetjet hulumtuese dhe hipotezat), lista e fotove, grafikave e shkurtesave dhe hyrja.

Kapitujt kanë këtë përmbajtje strukturore:

- Në kapitullin e parë të titulluar: "**ARSIMI SHQIPTARË PARA REFORMAVE**", është trajtuar çështje para reformimit të arsimit në Shqipëri, duke parë gjendje e arsimit para viteve 1925, qeveritë të cilat do vinin në pushtet do të merreshin me çështje të ndryshme, e në aspektin e arsimit do fillonin me kualifikimin e mësimdhënësve, linjën buxhetor të ministrisë së arsimit, po ashtu edhe me tekstet shkollore të cilat ishin përdor dhe me ato të cilat do përdoren përgjatë viteve në vazhdim.
- Në kapitullin e dytë të titulluar: "**REFORMATA ARSIMORE GJATË VITEVE 1925-1939**", fillon me ardhjen në pushtet të ministrit Hilë Mosi cili do të fillonte me reformimin e arsimit shqiptar, rrugën e tij do ta vazhdonte edhe ministri Mirash Ivanaj i cilat kishin arritur që me reformat e ndërmarra të reformonte arsimin dhe ti jepnin kahe kombëtare, por në këtë kapitull trajtohet edhe kundërshtimi i këtyre reformave arsimore.

- Në kapitullin e tretë të titulluar: **“ZHVILLIMI I INSTITUCIONEVE SHKOLLORE GJATË VITEVE 1925-1939”**, janë trajtuar arsimimi i nxënësve shqiptarë nga cikli parafillor e deri tek arsimimi i mesëm, ku është shtjelluara planprogrami arsimor i secilit cikël shkollor.

Në punimin e kësaj teme sa i përket metodave hulumtuese janë përdorur metodat kualitative dhe kuantitative. Ndërsa për të finalizuar janë përdorur metodat analitike dhe krahasimore. Dhe duhet përmendur në fund se për realizimin e këtij punimi janë shfrytëzuar një sërë burimesh arkivore të cilat janë marr nga Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSH), burime arkivore të botuara, literaturë e bollshme dhe e rëndësishme etj., me të cilat është arritur poashtu që të vendoset saktësia apo pasaktësia e hipotezave të ngritura më parë të cilat i kam paraqitur që në parathënie, e të cilat po i pasqyroj:

1. Reforma arsimore gjatë viteve 1925-1939 ndikoi në uljen e analfabetizmit.
2. Ahmet Zogu sa ishte në pushtete jo vetëm që punoi për reformimin e arsimit me ministrat e tij, por ai kishte arritur që të përmisonte edhe infrastrukturën arsimore, e cila vazhdoi të përdorej edhe pas Luftës së Dytë Botërore.